

## CV ENISA SHAHINI

Enisa SHAHINI u lind më 9 qershor 1991, në Tiranë. Në vitin 2012 ka përfunduar studimet e larta “Bachelor”, në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Ka kryer në vitin 2014 studimet master në programin e studimit “Master Shkencor- E Drejtë Civile”. Në vitin 2014-2015 ka ndjekur dhe ka përfunduar Shkollën e Avokatisë.

Përgjatë periudhës 2014-2015 është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës në lëndë të së drejtës civile. Gjatë periudhës 2015-2016 është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në lëndë të së drejtës penale.

Ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, gjatë viteve 2016-2019 dhe në përfundim ka marrë titullin “Magjistrat në profilin Gjyqtar”. Në janar të vitit 2020, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është emëruar gjyqtare dhe është caktuar në pozicionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Me vendimin nr. 435, datë 14.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtare Enisa Shahini është komanduar në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë.